



№/Adresa:

Nr. 1-116

Data 28.06.2019

Dr. Datum

OBILIQ OBILIQ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**RREGULLORE (KO)NR. ___/2019 PËR SUBVENCIONIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE ÇAKTIMIN E KUOTËS MË TË ULËT
PËR ÇMIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË ZONËN E RREZIKUAR
MJEDISORE NË KOMUNËN E OBILIQIT**

Qershor 2019, OBILIQ

Në pajtim me Nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale nenit 7, nenit 8, pika 2.1 e Ligjit Nr.05/L-044 Për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, si dhe nenit 37, pika 1.19 të Statutit të Komunës së Obiliqit, 01. nr.34 të datës 25/04/2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. _____, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR SUBVENCIONIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE CAKTIMIN E KUOTËS MË TË ULËT PËR ÇMIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË ZONËN E RREZIKUAR MJEDISORE NË KOMUNËN E OBILIQIT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës së Obiliqit subvencionimin e energjisë elektrike të shpenzuar, dhe një kuotë më të ulët të çmimit të energjisë elektrike.
2. Kjo rregullore zbatohet për banorët e përhershëm të cilët jetojnë dhe veprojnë në komunën e Obiliqit sipas Ligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij.
3. Të gjithë ata/ato të cilët janë përfitues të subvencionimit të energjisë elektrike të shpenzuar nga cilido institucion nuk mund të jenë përfitues për të njëjtin qëllim (energji elektrike).

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Banorë** - Banorët e përhershëm që jetojnë në zonën e rrezikuar, së paku 2 vite (24 muaj)
 - 1.2. **Neni 3** – Komuna e Obiliqit përfshin tërësin territoriale ashtu siq përcaktohet me zonën kadastrale të Komunës
 - 1.3. **Komuna** - Komuna e Obiliqit
 - 1.4. **Ministria** – Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapsinor;

1.5. Qeveria - Qeveria e Republikës së Kosovës

1.6. KEDS - Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike SLLA

1.7. KESCO - Kompani Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike

Neni 3

Ndarja e buxhetit

1. Qeveria e ndan një shumë të caktuar të mjeteve buxhetore duke u bazuar në Ligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, ku një pjesë nga ky buxhet është destinuar për Subvencionimin e Energjisë Elektrike.

Neni 4

Bashkëpunimi

1. Komuna e Obiliqit për realizimin e kuotës më të ulët të çmimit të energjisë elektrike për banorët e komunës, bashkëpunon me Qeverinë dhe Ministrinë, për zbatimin e nenit 8 pika 2 dhe 2.2 të Ligjit Nr.05/L-044 .
2. Komuna e Obiliqit për realizimin e Subvencionimit të energjisë elektrike të shpenzuar për banorët e komunës së Obiliqit, bashkëpunon me KEDS-Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A., dhe KESCO-Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike.

Neni 5

Rregullat e përgjithshme të ndarjes buxhetore

1. Komuna mund të Subvencionoj në shpenzimin e energjisë elektrike të shpenzuar të banorëve të Komunës, dhe të caktojë një kuotë më të ulët të çmimit të energjisë elektrike, në kufijt administrativ, vlera e cila caktohet për subvencionim miratohet nga ana e kuvendit komunal dhe aprovohet nga parlamenti i Republikës së Kosovës.
2. Kjo kuotë përfshin tërë banorët e komunës së Obiliqit duke u bazuar në Ligjin Nr.05/L-044 të nenit 4 pika 1 dhe 2.

3. Subvencionimi përcaktohet në bazë të shpenzimit totale të konsumit të energjisë në Komunën e Obiliqit duke e llogaritur në përqindje me shumën e mjeteve të ndara për Subvencionimin e Energjisë Elektrike.

Neni 6 Transparenca

1. Komuna publikon në web faqen zyrtare të komunës çmimin total të shpenzimit të konsumit të energjisë elektrike nga ana e qytetarëve të komunës së Obiliqit të cilët përfshihen në subvencionin e energjisë elektrike dhe përqindjen e kuotës më të ulët të çmimit.

Neni 7 Formimi i komisionit

1. Kryetari i Komunës emron një komision për verifikimin e shpenzimit të energjisë elektrike për subvencionim, për banorët e Komunës së Obiliqit, në bashkëpunim me KEDS-in dhe KESCO-në
2. Komisioni do të veprojë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që jepen nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal.
3. Përbërja e Komisionit duhet të jetë prej 3-5 anëtar, nga administrata komunale dhe kuvendi komunal
4. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
5. Anëtarët e Komisionit për verifikimin e shpenzimit dhe të kuotës më të ulët, mbajnë përgjegjësi dhe i raportojnë kryetarit të komunës dhe kuvendit komunal.
6. Para se të arrihet marrëveshja me KEDS dhe KESCO për subvencionimin e energjisë elektrike të shpenzuar, komisioni duhet të nxjerr shifrat e sakta të konsumatorëve aktiv të amvisërisë, dhe duke u bazuar në buxhetin e miratuar nga Kuvendi Komunal dhe Parlamenti i Republikës së Kosovës përcakton % e subvencionimit për vitet kalendarike.

Neni 8 Arritja e marrëveshjes

1. Për realizimin e subvencionimit të energjisë elektrike të shpenzuar, për banorët e Komunës së Obiliqit, duhet të arrihet marrëveshje në mes të Kryetarit të Komunës, KEDS-it, dhe KESCO-së me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat në mes të palëve, për arritjen e kësaj marrëveshje Kryetari i Komunës Autorizohet nga Kuvendi Komunal.
2. Kuvendi duhet të autorizoj komisionin e formuar ai për hartimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit.
3. Kuvendi duhet të nxjerr vendim të autorizoj Kryetarin, që pas aprovimit të marrëveshjes nga ana e kuvendit, për nënshkrimin e saj me palët KEDS dhe KESCO.
4. Marrëveshja duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të marrëveshjes, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen, konfor autorizimit të Kuvendit.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 9 Zbatimi i rregullores

1. Zbatimin e kësaj rregullore nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës e bëjnë: Drejtoria Për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.
2. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregullore dhe dispozitave të ligjeve në fuqi, do të aplikohen dispozitat e këtyre të fundit.

Neni 10
Hyrja ne fuqi

Ky Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT

nr. 1-116 datë 28-06-2019

